



REPUBLIKA E KOSOVËS—REPUBLIC OF KOSOVA—REPUBLIKA KOSOVA	
INSTITUTI HISTORISË—INSTITUTE OF HISTORY—INSTITUT ZA ISTORIJU	
Njësia Org. Org. Udh. Org. Jed.	1H
Nr. Prot. Prot. N. Br. Prot.	01131129
Nr. Faqeve No. Pages Gr. Stranica	148
Data: Date: Datum:	31.01.2025



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA

INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI"-PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI"-RISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI"-PRIŠTINA

Mbështetur në paragrafin 5 të nenit 23 të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore - Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), nën paragrafi 1.1. i nenit 18 të Statutit nr. 01B-195 dt. 31.10.2024, të Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, Udhëzimit administrativ nr. 01/2018 për parimet e njohjes se platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension dhe Udhëzimit Administrativ për Plotësimin dhe Precizimin (Aneksi-I- MASHT) 7/2018 e UA 01/2018 për Parimet e Njohjes se Platformave dhe Revistave Ndërkombëtare me Recension, Këshilli Drejtues i Institutit të Historisë "Ali Hadri", në mbledhjen e datës 31.01.2025, miratoi:

RREGULLORE PËR PROCEDURAT E ZGJEDHJES DHE RIZGJEDHJES SË PUNONJËSVE SHKENCOR DHE HULUMTUES NË INSTITUTIN E HISTORISË "ALI HADRI"

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin dhe përcaktimin e procedurave përzgjedhëse dhe procesin për zgjedhjen dhe rizgjedhjen e punonjësve shkencorë dhe hulumtuesve, në thirrjet: Këshilltar shkencor, Bashkëpunëtor i lartë shkencor, Bashkëpunëtor shkencor, Hulumtues i pavarur, Hulumtues dhe praktikant.
2. Çështjet që nuk janë rregulluar në mënyrë shprehimore në Statutin e Institutit të Historisë (IH) dhe në Ligjin për Veprimtari Kërkimore-Shkencore lidhur me procedurat recensuese për zgjedhjen dhe rizgjedhjen e punonjësve shkencorë dhe hulumtuesve, rregullohen në dispozitat vijuese të kësaj rregulloreje.

Neni 2

Punonjësit shkencor dhe hulumtuesit

1. Në pajtim me dispozitat e Statutit të Institutit dhe Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, personeli shkencor dhe hulumtues i Institutit të Historisë përbehet nga: Këshilltar shkencor; Bashkëpunëtor i lartë shkencor; Bashkëpunëtor shkencor; Hulumtues i pavarur dhe Hulumtues.

Neni 3

Kriteret për zgjedhjen dhe rizgjedhjen në titujt shkencorë dhe hulumtues

1. Procedura vlerësuese për zgjedhjen dhe rizgjedhjen në titujt shkencorë dhe hulumtues mbështetet në kriteret që dalin nga aktivitetet në vijim:
 - (1) Aktiviteti kërkimor - shkencor dhe profesional - shtojca I;
 - (2) Aktivitetet e tjera kërkimore dhe shkencore - shtojca II.
2. Për zgjedhjen dhe rizgjedhjen e kandidatëve në titujt përkatëse, kërkohet plotësimi i minimumit të kriterëve të parapara në Ligjin për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, Statutin e IH-së dhe në shtojcat përkatëse të kësaj rregulloreje.
3. Kandidati i cili punësohet për herë të parë në Institut, nuk mund të jetë më i vjetër se 50 vjet.
4. Shtojcat I dhe II janë pjesë përbërëse të rregullores.

Neni 4

Zgjedhja në thirrjen këshilltar shkencor

1. Në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, për titullin e këshilltarit shkencor, kandidati duhet të ketë këto kualifikime:
 - 1.1. Të ketë gradën e doktorit të shkencave;
 - 1.2. Të tregojë nivel të lartë kompetence e përvojë shkencore për fushën (periudhën historike) që dëshmohet;
 - 1.3. Të ketë dy (2) vepra shkencore monografike, një pas zgjedhjes së fundit dhe dy (2) vëllime me dokumente, një pas zgjedhjes së fundit, nga periudha përkatëse, të botuara nga institucionet kërkimore-shkencore, institucionet e arsimit të lartë dhe akademitë e shkencave;
 - 1.3.1. Më se paku pesë (5) punime shkencore të publikuara në revista shkencore relevante ndërkombëtare nga periudha përkatëse, dy (2) prej tyre pas zgjedhjes së fundit, dhe që ka marrë pjesë me sukses në organizimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore;
 - 1.4. Të ketë pjesëmarrje aktive së paku në tri (3) konferenca, nga të cilat së paku një (1) ndërkombëtare;
 - 1.5. Përvojë së paku në dy (2) projekte kërkimore-shkencore, të realizuara nga institucionet kërkimore-shkencore dhe profesionale;
 - 1.6. Aftësi për udhëheqje të projekteve kërkimore-shkencore dhe akademike;
 - 1.7. Titulli këshilltar shkencor është i përhershëm.
2. Kandidati mund të konsiderohet si autor i parë ose bashkautorë i punimeve të publikuara në revista shkencore në frymën e pikës 1.3 të këtij neni vetëm nëse plotësohen kriteret e specifikuar në paragrafin A të Shtojcës I të kësaj rregulloreje.

Neni 5

Zgjedhja/rizgjedhja në thirrjen bashkëpunëtor i lartë shkencor

1. Në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, për titullin e bashkëpunëtorit të lartë shkencor, në kohëzgjatje prej katër (4) vjetësh, kandidati duhet të ketë këto kualifikime:
 - 1.1. Të ketë gradën e doktorit të shkencave;
 - 1.2. Të tregojë nivel të lartë kompetence e përvojë shkencore për fushën (periudhën historike) që dëshmohet;
 - 1.3. Të ketë një (1) vepër shkencore monografike pas zgjedhjes së fundit dhe një (1) vëllim me dokumente pas zgjedhjes së fundit nga periudha përkatëse, të botuara nga institucionet kërkimore-shkencore, institucionet e arsimit të lartë dhe akademitë e shkencave;
 - 1.3.1. Më se paku 3 punime shkencore të publikuara në revista shkencore relevante ndërkombëtare nga periudha përkatëse, dy (2) prej tyre pas zgjedhjes së fundit, dhe që ka marrë pjesë me sukses në organizimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore;
 - 1.4. Të ketë pjesëmarrje aktive së paku në dy (2) konferenca, nga të cilat së paku një (1) ndërkombëtare;
 - 1.5. Përvojë së paku në një (1) projekt kërkimorë-shkencorë, të realizuara nga institucionet kërkimore-shkencore dhe profesionale;
 - 1.6. Aftësi për udhëheqje të projekteve kërkimore-shkencore dhe akademike.
2. Kandidati mund të konsiderohet si autor i parë ose bashkautorë i punimeve të publikuara në revista shkencore në frymën e pikës 1.3 të këtij neni vetëm nëse plotësohen kriteret e specifikuar në paragrafin A të shtojcës I të kësaj rregulloreje.

Neni 6

Zgjedhja/rizgjedhja në thirrjen bashkëpunëtor shkencor

1. Në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, për titullin e bashkëpunëtorit shkencor, në kohëzgjatje prej katër (4) vjetësh, kandidati duhet të ketë këto kualifikime:
 - 1.1. Të ketë gradën e doktorit të shkencave;
 - 1.2. Të tregojë nivel të lartë kompetence e përvojëshkencore për fushën (periudhën historike) që dëshmohet;
 - 1.3. Më se paku një (1) punim të publikuar në revista shkencore relevante ndërkombëtare;
 - 1.4. Të ketë pjesëmarrje aktive në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, së paku në dy (2) konferenca kombëtare dhe në një (1) konferencë ndërkombëtare;
 - 1.5. Aftësi për kërkime shkencore.
2. Kandidati mund të konsiderohet si autor i parë ose bashkautorë i punimeve të publikuara në revista shkencore në frymën e pikës 1.3 të këtij neni vetëm nëse plotësohen kriteret e specifikuar në paragrafin A të shtojcës I të kësaj rregulloreje.

Neni 7
Zgjedhja/rizgjedhja në thirrjen hulumtues i pavarur

1. Në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, për titullin Hulumtues i pavarur, në kohëzgjatje prej tri (3) vjetësh, kandidati duhet të ketë këto kualifikime:
 - 1.1. Të ketë të përfunduar me sukses studimet *master* në drejtimin përkatës;
 - 1.2. Të jetë i regjistruar në studimet e doktoratës dhe që ka punime të publikuara në revista shkencore.
2. Mandati i hulumtuesit të pavarur është 3 vjet më të drejtë rizgjedhje edhe për një mandat. Përjashtimisht hulumtuesi i pavarur i cili është rizgjedhur për mandatin e dytë, mund ti hapet konkursi për tu avancuar në thirrjen bashkëpunëtor shkencor pa e konsumuar mandatin me rastin kur konstatohet-vlerësohet që i plotëson kriteret.
3. Hulumtuesit nga paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni mund të zgjedhën në titullin e njëjtë edhe për një mandat.
4. Në rast të rrethanave të cilat hulumtuesi i pavarur është në procedurën përfundimtare të mbrojtjes së temës së doktoratës të cilat i udhëheq Universiteti përkatës, të njëjtit do t'i vazhdohet pozita në Institut, për një periudhe dy vjeçare.
5. Hulumtuesit të pavarur do t'i caktohet një mentor nga radhët e punonjësve shkencor të Institutit, për realizimin e objektivave të tij/saj në avancimin shkencor.

Neni 8
Zgjedhja në thirrjen hulumtues

1. Në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, për titullin e hulumtuesit, në kohëzgjatje prej tri (3) vjetësh, kandidati duhet të ketë këto kualifikime:
 - 1.1. Të ketë të përfunduar me sukses studimet bachelor dhe ato master në drejtimin përkatës;
 - 1.2. Hulumtues, në kohëzgjatje prej tri (3) vjetësh, zgjidhet personi me studime përkatëse themelore më notë mesatare tetë (8) e sipër dhe që ka kryer studimet për master shkencor, që nuk ka më shumë se njëzet e shtate (27) vjet.
2. Hulumtuesit do t'i caktohet një mentor nga radhët e punonjësve shkencor të Institutit, për realizimin e objektivave të tij/saj në avancimin shkencor.

Neni 9
Vlerësimi

1. Zgjedhja e punonjësve shkencorë dhe e hulumtuesve bëhet në bazë të konkursit publik.
2. Mendimin se kandidati i përmbush ose jo kushtet për zgjedhje në titullin shkencor ose në titullin hulumtues, e jep komisioni recensues i emëruar nga Këshilli shkencor i Institutit, i cili zbaton procedurën e konkursit.
3. Komisioni recensues profesional përbëhet prej tre (3) anëtarëve, dy (2) prej të cilëve duhet të jenë nga fusha e ngushtë profesionale dhe nuk bën të jenë më tituj më të ulët se titulli për të cilin e shkruajnë recensionin.

Neni 10

Lidhja dhe shkëputja e marrëdhënies së punës

1. Punonjësit shkencorë dhe hulumtuesit lidhin me institutin kontratën për punën në pajtim me Legjislacionin në fuqi.
2. Kontrata e punës e lidhur midis punonjësit shkencor ose hulumtuesit dhe Institutit shkëputët:
 - 2.1. Më kërkesën e punonjësit shkencor ose të hulumtuesit;
 - 2.2. Në qofte se punonjësit shkencor ose hulumtuesi e humb statusin e punonjësit shkencor, për shkak se nuk zgjedhet ose rizgjedhet në titullin e paraparë;
 - 2.3. Nëse punonjësi shkencor ose hulumtuesi dështon në realizimin e obligimeve të përcaktuara në kontratë;
 - 2.4. Nëse punonjësi shkencor ose hulumtuesi nuk i përmbushë kushtet sipas dispozitës përkatëse mbi normën e punës;
 - 2.5. Nëse punonjësi shkencor ose hulumtuesi nuk e realizon qëllimisht apo e neglizhon realizimin e projektit shkencor;
 - 2.6. Nëse punonjësi shkencor ose hulumtuesi në vlerësimin e performancës së punës nuk e realizon planin e punës dhe projektin kërkimor;
 - 2.7. Nëse shkel kodin e etikës së punonjësit të institutit;
 - 2.8. Në qofte se punonjësi i shkel rënde detyrat e punës, ose me sjelljet e tij e ul autoritetin e Institutit;
 - 2.9. Zgjedhja e punonjësve shkencor dhe hulumtues të Institutit bëhet në bazë të konkursit publik;
 - 2.10. Në rastet e tjera të përcaktuara me ligj;
 - 2.11. Kontrata e punës më punonjësit e tjerë ndërpritet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 11

Marrja e vendimit për konkurs për zgjedhje dhe rizgjedhje në titujt shkencorë dhe hulumtues

1. Vendimin për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e rizgjedhjen e punonjësve shkencorë dhe të hulumtuesve e merr Këshilli shkencor.
2. Procedura e zgjedhjes-rizgjedhjes së punonjësve shkencorë dhe hulumtuesit zbatohet në harmoni me “Ligjin për veprimtari kërkimore-shkencorë”, të këtij “Statuti” dhe “Rregullores për zgjedhje dhe rizgjedhje të punonjësve shkencorë dhe hulumtues”.
3. Vendimi për zgjedhje/rizgjedhje merret gjashtë muaj para skadimit të afatit të kontratës së punonjësit shkencor ose të hulumtuesit.
4. Konkursi duhet të përsëritet nëse asnjëri nga kandidatet nuk i plotëson kriteret e parapara më legjislacionin në fuqi.

Neni 12

Procedurat e konkursit

1. Procedura e zgjedhjes dhe rizgjedhjes ose avancimit do të bëhet në mënyrë transparente dhe me shpalljen e konkursit publik për pozitën përkatëse në gazetën ditore ose ueb faqen zyrtare të Institutit. Kohëzgjatja e konkursit është pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike.
2. Konkursi për zgjedhje dhe rizgjedhje shpallet me vendim të Këshillit shkencor.
3. Konkursi duhet të përmbajë referencën e neneve përkatëse të Ligjit për Veprimtari Kërkimore - Shkencore, Statutit të Institutit të Historisë, Ligjit të Punës dhe të kësaj rregulloreje.
4. Kandidatët që i kanë mbaruar studimet jashtë vendit me rastin e aplikimit për zgjedhje, rizgjedhje apo avancim duhet të sjellin vendimin për nostrifikimin (barasvlerën) e diplomës përkatëse (baçelor, master, magjistraturë, doktoratë).
5. Aplikuesit duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme në formë të shtypur dhe në formë elektronike në adresën zyrtare të Institutit të Historisë "Ali Hadri".

Neni 13

Komisionet recensues

1. Këshilli shkencor është i obliguar që për çdo pozitë të shpallur në konkurs ta caktojë Komisionin recensues.
2. Komisioni recensues profesional, sipas paragrafit 1 të këtij neni, përbëhet prej tre anëtarëve, dy prej të cilëve duhet të jenë nga fusha e ngushte profesionale, anëtari i komisionit mund të jetë edhe i jashtëm. Komisionet vlerësuese janë organe me kredibilitet të lartë profesional, akademik dhe etik.
3. Mendimin se kandidati i përmbush ose jo kushtet për zgjedhje në titullin shkencor ose në titullin hulumtues, e jep komisioni recensues, i cili zbaton procedurën e konkursit.
4. Komisioni recensues profesional përbëhet se paku prej tre (3) anëtarëve, dy (2) prej të cilëve duhet të jenë nga fusha e ngushte profesionale dhe nuk bën të jenë më tituj më të ulët se titulli për të cilin e shkruajnë recensionin.
5. Anëtarët e komisionit recensues kanë përgjegjësi për zbatimin e drejte dhe të paanshëm të të gjitha dispozitave të "Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore", "Statutit" të Institutit dhe "Rregullores për zgjedhje dhe rizgjedhje". Dështimi i zbatimit ligjor të këtyre dispozitave nënkupton shkelje dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare lidhur me të drejtat dhe përgjegjësitë e kandidatit për pozitën përkatëse.
6. Anëtari i komisionit vlerësues më thirrje më të lartë akademike, më automatizëm, është kryetar i komisionit.
7. Në mungesë të numrit të mjaftueshëm të komisionit vlerësues si në paragrafin 5 dhe 6 të këtij neni, në përbërje të komisionit vlerësues mund të emërohen edhe anëtarë/profesorë nga institucionet tjera shkencore dhe akademike.
8. Anëtarët e komisionit vlerësues mund të jenë edhe nga institute, akademi dhe universitete të tjera në

vend dhe jashtë vendit. Në këtë rast, së paku një (1) anëtar i komisionit është i brendshëm, nga Instituti i Historisë. Në rastet kur komisioni vlerësues ka dy (2) anëtarë të jashtëm, anëtar i brendshëm, me automatizëm, është kryetar i komisionit.

9. Në mungesë të anëtarëve në marrëdhënie të rregullt pune si në paragrafin 5, 6 dhe 8, anëtarë të komisionit vlerësues mund të jenë edhe personat e pensionuar, që kanë thirrjet e nevojshme akademike nga fusha përkatëse.
10. Në rast të arsyeve të bazuara, anëtar i komisionit, në afat prej pesë (5) ditëve pas formimit të komisionit vlerësues, mund të deklarojë me shkrim tërheqjen e tij nga komisioni. Në këtë rast, drejtori i Institutit, thërret mbledhjen e Këshillit shkencor dhe, në rast të aprovimit të dorëheqjes, kërkon nga Këshilli plotësimin, përkatësisht formimin e komisionit tjetër recensues.
11. Kryetari i komisionit vlerësues është i obliguar të thërrasë anëtarët e tjerë të komisionit dhe ta hartojë dhe dorëzojë raportin e vlerësimit për kandidatët e paraqitur në konkurs.
12. Komisioni recensues brenda afatit prej 3 ditëve pune i tërheq dosjet e konkursit. Komisioni obligohet që brenda 10 ditëve pas tërheqjes së dosjeve ta dorëzojë referatin e nënshkruar dhe të protokolluar.
13. Komisioni vlerësues është i obliguar që gjatë punës së tij të respektojë dispozitat e Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencorë, Statutin e Institutit të Historisë, këtë rregullore, kushtet e konkursit dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
14. Komisioni Vlerësues është i obliguar që t'u japë përparësi kandidatëve, të cilët i plotësojnë kriteret e nevojshme dhe të cilët, bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të aktivitetit të tyre shkencor, profesional dhe akademik, janë më të mirë në krahasim me kandidatët tjerë. Komisioni duhet të arsyetojë rekomandimin e bërë në frymën e këtij paragrafi.
15. Në raportin e komisionit vlerësues duhet të bëhet i qartë propozimi për zgjedhjen apo rizgjedhjen e kandidatëve në numrin e kërkuar me konkurs dhe të dallohet nga propozimi për kandidatët, të cilët nuk janë zgjedhur.
16. Komisioni recensues është i obliguar të shkruajë raport edhe për kandidatët, të cilët i plotësojnë kushtet minimale, por të cilët nuk janë propozuar të zgjedhen/rizgjedhen. Për kandidatët, të cilët nuk i plotësojnë kushtet minimale mjafton të cekën kushtet (e parapara në konkurs), të cilat nuk janë plotësuar.
17. Nëse ndonjëri nga anëtarët e komisionit recensues ka mendim të ndryshëm në lidhje me propozimin për zgjedhje/rizgjedhjen e kandidatit, ai anëtar është i obliguar që të paraqesë një "*propozim të ndarë*" për Këshillin shkencor. Vlerësimet në raport bëhen në përputhje me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në statut dhe të detajuara në këtë rregullore. Në raste të tilla, Këshilli shkencor diskuton të dyja propozimet dhe vendos më shumicë votash për raportin.
18. Këshilli shkencor i Institutit mban të drejtën të refuzojë propozimet, por nuk mund t'i miratojë të dyja propozimet e ndara për të njëjtën pozitë.
19. Anëtarët e komisionit recensues mbajnë përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe etike për vërtetësinë e të dhënave të shënuara në raportin e vlerësimit dhe për rekomandimet që bëjnë. Në rast se rekomandimet e tyre bien qartazi ndesh me Statutin e Institutit dhe këtë rregullore, veprimet e tyre sanksionohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.
20. Zyra e administratës së Institutit është e obliguar që brenda shtatë (7) ditëve pas vendimit të Këshillit

shkencorë, të njoftohen mbi vendimin kandidatët pjesëmarrës në procesin e zgjedhjes/rizgjedhjes.

21. Ndaj vendimit të Këshillit shkencor, në afat jo më larg se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas pranimit të njoftimit për vendim, mund të bëhet ankesë në Komisionin e Institutit për Ankesa, që shërben si instancë e parë dhe e fundit e ankimit në Institut.
22. Kontrata e punës për punonjës in e zgjedhur/rizgjedhur, sipas vendimit të Këshillit shkencor, do të nënshkruhet vetëm nëse për lëndën përkatëse, brenda afatit ligjor, nuk ushtrohet ankesë, respektivisht në rast të ankesës, deri në një vendim përfundimtar të Inspektoratit të Punës.

Neni 14

Referati i komisionit

1. Referati i komisionit duhet të përmbajë:
 - 1.1. Shënimet biografike dhe bibliografike të kandidatit;
 - 1.2. Vlerësimin e punës së tij/saj shkencore;
 - 1.3. Propozimin për zgjedhje/rizgjedhje.
2. Komisioni recensues, më rastin e dhënies se propozimit për zgjedhjen/rizgjedhjen e punonjës it shkencor dhe hulumtuesve, duhet të ketë parasysh dispozitat ligjore dhe aktet e tjera nënligjore, për vlerësimin e punës kërkimore-shkencore.
3. Kryetari i komisionit recensues është i obliguar të thërrasë anëtarët e tjerë të Komisionit dhe ta hartoj në raportin e vlerësimit (Referatin) për kandidatet e paraqitur në konkurs, të cilin ja dorëzojnë Këshillit shkencor.
4. Referati, sipas paragrafit 1 të këtij neni, publikohet në web-faqe të Institutit-për 15 ditë kalendari ke para marrjes së vendimit nga Këshilli shkencor.
5. Këshilli shkencor i Institutit, në bazë të mendimit të Komisionit recensues, merr vendim për zgjedhjen-rizgjedhjen e kandidatit të propozuar në titullin përkatës shkencor ose hulumtues.
6. Në rastet kur Komisioni recensues, respektivisht ndonjë prej anëtarëve të Komisionit, nuk i përfill kriteret dhe procedurat e vlerësimit, drejtori-ja inicion zëvendësimin e tij /saj.
7. Procedura e konkursit duhet të përfundojë brenda afatit prej tre muajsh.
8. Procedura e zgjedhjes dhe rizgjedhjes rregullohet me Ligj, Statutin e Institutit dhe këtë rregullore.

Neni 15

Angazhimi dhe aftësimi i praktikanteve në Institut

1. Instituti, në bazë të planifikimit vjetor për përgatitjen dhe aftësimin e kuadrit të ri shkencor, pranon praktikantë, më qëllim të aftësimit dhe përgatitjes shkencore e profesionale të tyre.
2. Praktikant mund të zgjedhet personi më studime përkatëse themelore, më notë mesatare tetë (8) e sipër.
3. Praktikant mund të zgjedhet personi që nuk ka më shumë se njëzet e katër (24) vjet;
4. Praktikanti zgjedhet në kohëzgjatje prej 1 vit më mundësi të vazhdimit të angazhimit edhe për një vit

tjetër.

5. Gjatë periudhës së angazhimit, praktikantët do të angazhohen në projektet kërkimore të departamentit përkatëse, për të cilët do të përkujdeset Shefi i departamentit.
6. Praktikanti do të punoj si asistent për zbatimin e projekteve shkencore të Institutit të Historisë dhe punonjësve shkencor nën direktivat e tyre.
7. Paga e praktikantit do të jetë e barasvlershme më pagën mesatare në Kosovë.
8. Instituti nuk ka asnjë obligim punësimi pas përfundimit të praktikës së tyre.
9. Procedura e pranimit të praktikanteve-stazhiereve zhvillohet njësoj sikur për zgjedhjen e punonjësve shkencore dhe të hulumtuesve.
10. Angazhimi i praktikantit në Institut nuk nënkupton punësim, pasi statusi i praktikantit nuk konsiderohet marrëdhënie pune. Për këtë arsye, pranimi dhe angazhimi i praktikantëve nuk kërkon kuotë apo vend të lirë punësimi në Institut, por realizohet në bazë të nevojave për aftësimin dhe përgatitjen e kuadrove të rinj shkencorë, në përputhje me Statutin dhe legjislacionin në fuqi.
11. Kompensimi i praktikantit mund të bëhet nga mjetet e siguruar për veprimtarinë kërkimore-shkencore, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 16

Dispozitat kalimtare


1. Punimet që botohen pas hyrjes në fuqi të rregullore, do të merren parasysh vetëm nëse janë të publikuara në revista dhe platformat të cilat janë të specifikuara në shtojcën I, paragrafi A.
2. Ky nen nuk do të aplikohet për zgjedhjet dhe rizgjedhjet në thirrjet e fituara para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 17

Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Institutit të Historisë “Ali Hadri”.

Drejtoreshë
Prof. dr. Teuta SHALA-PENI



Shtojca I

FORMULAR PËR VEPRIMTARINË KËRKIMORE, SHKENCORE DHE PROFESIONALE

A. Autori i parë, autori korrespondent dhe punimet e publikuara në revista ndërkombëtare

Në përputhje me Ligjin për Veprimtari Kërkimore-Shkencore dhe Statutin e Institutit, punimi i publikuar në revistë ndërkombëtare shkencore mund të shfrytëzohet për nevoja të zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit nga autori i parë i punimit dhe nga autori korrespondent.

A.1. Për autorin korrespondent të punimit të publikuar në revistë ndërkombëtare shkencore, vlejné përkufizimet vijuese:

- a) Si autor korrespondent konsiderohet autori i cili është i identifikuar si i tillë në punimin e publikuar;
- b) Nëse në punimin e publikuar janë specifikuar me shume se një autor korrespondent, si autor korrespondent konsiderohet autori i parë i identifikuar si i tillë;
- c) Nëse në punimin e publikuar janë vetëm dy autorë dhe autori korrespondent nuk është specifikuar, autori i dytë konsiderohet si autor korrespondent;

A.2. Bazuar në Ligjin për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, Statutin e Institutit dhe aktet tjera ligjore në fuqi, si punime të publikuara në revista ndërkombëtare shkencore gjatë vlerësimit të kandidatëve të paraqitur në konkurs, vlejné punimet e publikuara në fushën e kandidatit, në revista të cilat janë të indeksuara në bazat përkatëse akademike dhe të kategorizuara si në vijim:

A.2.1. Punimet e publikuara në revista ndërkombëtare, të cilat janë të indeksuara në bazat akademike vijuese janë të barasvlershme me 1:

1. Web of Science: Core Collection (<https://mjl.clarivate.com/home>)
2. Scopus (Elsevier) (<https://www.elsevier.com/solutions/scopus>)
3. EBSCOhost (<https://www.ebsco.com>)
4. WorldCat (<https://www.worldcat.org/>)
5. Directory of Open Access Journals (<https://doaj.org/>)

A.2.2. Punimet e publikuara në revista kombëtare dhe botime të veçanta, të cilat janë të barasvlershme me 0.50.

1. Kosova (https://albanica.al/revista_kosova/)
2. Studia Albanica (<https://albanica.al/studialbanica>)
3. Studime Historike (<https://ih-revista.edu.al/index.php/ih-revista>)
4. Iliria (<https://www.persee.fr/colection/iliri>); Candavia (<https://www.qsa.edu.al>)
5. Botime të veçanta të Instituteve shkencore dhe Akademive të shkencave duke përfshirë libër të edituar me punime të veçanta dhe ato të konferencës.

A.2.3. Punimet e publikuara në revista, të cilat janë të indeksuara në bazat akademike vijuese barasvlerësohen me 0.85:

1. WorldWideScience (<https://worldwidescience.org/>)
2. Microsoft Academic Search (<https://academic.microsoft.com/home>)
3. BASE (Bielefeld Academic Search Engine) (<https://www.base-search.net/>)

A.2.4. Punimet e publikuara në revista të cilat janë të indeksuara në bazat akademike vijuese barasvlerësohen me 0.70:

1. Hrvatska znanstvena bibliografija (<https://bib.irb.hr/>)
2. ULAKBIM - National Academic Network and Information Center (<https://cabim.ulakbim.gov.tr/tr-dizi%20n/tr-dizinde-dizinlenen-dergi-listesi>)
3. CAB Direct (<https://www.cabdirect.org/cabdirect/>)
4. ProQuest(<https://www.proquest.com/libraries/academic/>)
5. Open akademik Journals Index (<http://oaji.net/>)
6. JSTOR (<https://www.jstor.org/>)

A.2.5. Punimet e publikuara në revista vijuese barasvlerësohen me 0.50:

1. Studime shoqërore (<http://www.ashak.org/?cid=1,31>)
2. Gjurmime Albanologjike (<http://CEEOL>)

A.2.6. Pjesëmarrja në Konferencë shkencore të organizuar nga institucioni publik kërkimor-shkencor vendor dhe ndërkombëtar është i barasvlerëshëm me 0.30.

Tabela 1.1 Publikimet në revista që plotësojnë kushtet si në paragrafët A2.1.

Nr.	Emri dhe mbiemri i autorit	Titulli i punimit	Revista	Vëll., nr., (viti), faqet	Linku i publikimit ²
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					

² Komisioni vlerësues është i obliguar të shënojë linkun, nëpërmjet të cilit dëshmohet indeksimi i punimit, përkatësisht revistës në bazën e caktuar akademike, respektivisht linkun e punimit në revistën përkatëse të paragrafit A2.1-A2.6.

Tabela 1.2 Publikimet në revista, botime dhe konferenca që plotësojnë kushtet si në paragrafët A.2.2, A.2.3, A.2.4, A.2.5 dhe A.2.6.

Nr.	Emri dhe mbiemri i autorit	Titulli i punimit	Revista	Vëll., nr., (viti), faqet
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				

Shtojca II

FORMULAR PER AKTIVITETIN BOTUES NË BOTIMET MONOGRAFIKE, SHKENCORE, DOKUMENTE DHE PËRKTHIME

A. Publikimet e monografive studimore, librave me dokumente, përkthimeve në fushën e kandidatit (në cilësinë e autorit të parë ose bashkautorit)

Tabela 1.1 Publikimet e monografive, librave me dokumente, përkthimeve etj., në gjuhë të huaja.

Nr.	Autori/Autorët	Titulli	Lloji i botimit	Botuesi	Vendi dhe viti
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					

Tabela 1.2 Publikimet e monografive studimore, librave me dokumente, përkthimeve etj., në gjuhën shqipe.

Nr.	Autori/Autorët	Titulli	Lloji i botimit	Botuesi	Vendi dhe viti
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					

B. Publikimet nga sesionet, konferencat, simpoziumet, tryezat shkencore
(në cilësinë e autorit të parë ose bashkautorit)

Tabela 1.1 Publikimet nga sesionet, konferencat, simpoziumet, tryezat shkencore në nivel ndërkombëtar (jashtë vendit).

Nr.	Autori/Autorët	Titulli i punimit	Konferenca, simpoziumi	Botuesi dhe vendi	Vëllimi, nr. (viti), faqet
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					

Tabela 1.2 Publikimet nga sesionet, konferencat, simpoziumet, tryezat shkencore në nivel vendorë.

Nr.	Autori/Autorët	Titulli i punimit	Konferenca, simpoziumi	Botuesi dhe vendi	Vëllimi, nr. (viti), faqet
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					

C. Aktivitetet tjetra kërkimore shkencore

Tabela 1.1 Prezantimet gojore-shkencore në konferenca, simpoziume, punonjësi shkencore dhe në universitete (si ligjërues i ftuar) nga fusha e kandidatit.

Nr.	Autori/Autorët/ prezantuesi	Titulli i kumtesës	Emri i konferencës, simpoziumit, organizatori	Vendi dhe viti
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				

Tabela 1.2 Kryeredaktor, redaktor shkencor, redaktor, recensues në botime monografike, dokumente dhe përmbledhje.

Nr.	Kontributi (redaktorë, recensues...)	Autori origjinal i librit	Titulli i librit	Vendi dhe viti
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				

Tabela 1.3 Redaktorë, recensues, anëtarë redaksie në revista akademike dhe shkencore.

Nr.	Kontributi (redaktorë, recensues...)	Autori origjinal i librit	Revista e cila është redaktuar ose për të cilën është shkruar recension	Vendi dhe viti
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				

Tabela 1.4 Kontribute tjera shkencore dhe profesionale.

Nr.	Autori/autorët	Lloji i kontributit shkencorë	Vendi dhe viti
1.			
2.			
3.			
4.			
5.			

D. Kontribute në projekte të kërkimeve shkencore

Tabela 1.1 Pjesëmarrja e dëshmuar në programe ose projekte të kërkimeve shkencore.

Nr.	Programi/ projekti shkencor	Periudha kohore	Poziciononi në projekt	Institucioni dhe vendi
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				